

Syllabusi i lëndës

Lënda: Fik`h II - *E Drejta Familjare*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 208

Fondi i orëve: 3+3

Viti akademik: 2015/2016

Semestri: IV

Mësimdhënësi: Mr. Vaxhide Podvorica

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Lënda: “E Drejta Familjare” përfshinë dy fusha : Martesën dhe shkurorëzimin.

Pjesa e parë e kësaj lënde përmban këto pikë kryesore:

- Familja si shtyllë kryesore e shoqërisë,rëndësia e saj. Pastaj fejesa, rregullat e saja, mënyra e saj. Martesa si ligj hyjnor,urtësia e saj, norma e saj, kushtet e saj, gratë me të cilat nuk lejohet martesa, çështja e “Veliut” (Kujdestarit të vajzës) si dhe mehri (dhurata) e gruas.

Ndërsa pjesa e dytë përmban:

- Shkurorëzimin, urtësinë e tij, e drejta e burrit në shkurorëzim, shprehjet për shkurorëzim, llojet e tij etj..

Pastaj periudha e pritjes në rastet e ndarjes së bashkëshortëve,rastet,llojet e saj etj. Gjithashtu kam paraqit edhe çështjen e kujdestarisë për fëmijët pas shkurorëzimit, e drejta e fëmiut për gjidhënje, kushtet e saj etj...

Qëllimi i lëndës

Kjo lëndë studion të drejtën Familjare sipas Islamit dhe kryesisht ka për qëllim studimin e lidhjes bashkëshortore në mes burrit dhe gruas; Kurorëzimin, dhe po ashtu kjo lënd studion edhe qështjen e shkurorëzimit. Qëllimi i lëndës është mësimi i procedurave juridike, sipas Islamit, në bazë të të cilave bëhet lidhja martesore ne mes dy bashkëshorteve apo ndarja mes tyre.Pasi që dihet se familja është gurthemeli i një shoqërie atëherë është e nevojshme të i njohë parimet e saja çdo individ që të formohet një shoqëri e shndoshë e cila bënë praktikimin e mësimëve të tilla. Qëllimi i lëndës është përgatitje e studentit për praktikumin e mënyres së lidhjes martesore,rregullat e saja dhe ajo ne raste kur bashkjetesa nuk gjen rrugë dhe vie deri te ndarja mes bashkëshortëve. Ndër të tjerat, lënda ka për qëllim ngritjen ideore me rastin e kërkesës për martesë, apo shkurorëzim. Gjithsesi,

lënda synon të jap konceptin Islam mbi organizimin e jetës familjare dhe ndërtimin e raporteve të shëndosha duke dhënë edhe indeksin e përshkrimit të detyrave.

Rezultatet e pritura të nxënies:

1. Studenti do të mësoj se jeta vazhdon me përgjegjësi të natyrave të ndryshme.
2. Do të kuptoj se Islami e ka bërë të ligjshme martesën dhe e ka vënë atë brenda kornizave ligjore.
3. Mëson se Islami ka dhënë përgjigje dhe opsione të shumta për çështje jetike edhe në raste kur bashkëjetesa nuk gjen rrug, siq është ajo e divorcit.
4. Kupton se jeta familjare, në konceptin Islam është analizuar deri në detajet më të imta dhe është dhënë përgjigje për të gjitha situatat.
5. Studenti kupton se gjithsesi duhet të mendoj seriozisht për lidhjen martesore dhe ruajtjen e saj, duke mos ra në ato situata që të shpien deri te ndarja, sepse kjo është garancia më e mirë për jetë të qetë dhe shoqëri të shëndoshë.
6. Mëson se Islami paraqet një version shumë të avancuar të organizimit të jetës familjare.
7. Kupton se islami synon të ndaloj individin dhe shoqërinë nga devijimet morale dhe parandalon sëmundje shpirtërore të cilat për bazë kanë epshin.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimdhënia zhvillohet nëpërmes ligjëratave duke përdorur metoda të bashkë bisedimit me pjesëmarrje aktive nga studentët. Me forma të ndryshme të aktivitetit synohet të ngrihet cilësia dhe kualiteti i mësimdhënies. Temat e zhvilluara detyrimisht përfshijnë një numër të konsiderueshëm termash, sqarimi i të cilëve, obligon shfrytëzimin e literaturës në gjuhën arabe.

Që gjërat të jenë më të qarta mund të përdoren edhe metoda praktike ku studenti mëson se si zhvillohet një procedurë kurorëzimi. Mund të nxjerr një certifikatë si model për aktin e kurorëzimit dhe të improvizojë situata ku ai do të udhëhiqte një akt të tillë. Nëpërmes materies së lëndës studenti mëson metodologjinë e ligjshme për ndërmjetësimin dhe bashkimin e qifteve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë:

1. Prezantimi i lëndës, dhe syllabusit. 2. Familja themel i shoqërisë. 3. Konceptet bazë të sociologjisë së familjes.

Literatura: Tituj të Zgjedhur mbi Familjen Muslimane, faqe 21-29 dhe 41-85

Java e dytë:

1. Pozita e femrës gjatë historisë. 2 Pozita e femrës në shariat Islam. 3. Pozita e saj në

periudhat më të vlefshme të Islamit. 4. Pjesëmarrja në shoqëri dhe aktivitete të ndryshme.

Literatura: E Drejta Familjare në Islam, faqe 13-18

Java e tretë:

1. Definicioni i familjes. 2. Qëndrimi i islamit ndaj saj. 3. Rëndësia dhe detyrat e saja.

Literatura: Fikhu Sunneh, faqe 15-20

Java e katërt:

1. Fejesa te popujt dhe fetë tjera. Fejesa në Islam. 3. Procedurat paraprake të fejesës. 4. Shikimi i të fejuarve me veti. 5. Mënyra e fejesës. 6. Mosha e fejesë 7. Situata kur fejesa është e ndaluar. 8. Prishja e fejesës.

Literatura: E Drejta Familjare në Islam, faqe 30-44

1. Java e pestë:

1. Martesa si ligj i Allahut. 2. Forma të martesës që ka anuluar Islami 3. Nxitja për martesë. 4. Urtësia e martesës. 5. Statusi i martesës në jurisprondencën Islame.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 83-94

Java e gjashtë:

1. Martesa si akt ligjor i familjes. 2. Kushtet e martesës 3. Kushtet e lidhjes së kontratës. 4. Ekzistimi i dy palëve që bëjnë kontratë. 5. Lejimi i kontratës për martesë. 6. Dëshmia e kontratës 2. Kushtet e dëshmitarëve me rastin e aktit të kurorëzimit. 3. Koha e dëshmisë. 4. Kontrata të mos jetë e përkohshme. 5. Ndalimi i kurorëzimit me afat të caktuar (el mut'a).

Literatura: Tituj të Zgjedhur mbi Familjen Muslimane, faqe 30-37, E Drejta Familjare në Islam, faqe 58-66, Fikhu Sunneh, , Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe, 107-118

Java e shtatë:

1. Gratë- me të cilat është e ndaluar martesa. 2. Gratë e ndaluara përkohësisht. 3. Bashkimi i dy grave të ndaluara në një kurorë. 4. Martesa me gruan e dikujt tjetër. 5. Gruaja e divorcuar tri herë.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe, 141-170

Java e tetë: Kollokfijum

Java e nëntë: . Çështja e "Veliut" pësonit kompetent, në aktin e kurorëzimit (kujdestarit). 2. Kushtet e kujdestarit. 3. Kujdestaria e gruas për veten e vet në martesë. 4. Domosdoshmëria e marrjes së mendimit të vajzës (gruas) para martesës. 5. Mungesa e kujdestarit dhe autorizimi.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 192-208

Java e dhjetë:

1. Kushti i ngjashmërisë në martesë. 2. Mehri (Dhurata e kurorës), vlera e metrit, rregullat e dhënies së metrit dhe sasia. 3. Paja e nuses, shpenzimet për martesën. Të drejtat e bashkëshortëve, detyrat dhe obligimet në martesë. 4. Akti i martesës dhe ndërtimi i jetës së re familjare.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 209-259

Java e njëmbëdhjetë: 1.Shkurorzimi.2.Urtësia e shkurorzimit.3.E drejta e burrit në shkurorzim.4.Cilesit e burrit që ka të drejten e shkurorzimit.5.Llojet e shkurorzimit.

Literatura: E Drejta Familjare faqe198-209, Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 301-322

Java e dymbëdhjetë:1. Shkurorzimi në perputhje me dispozitat fetare dhe shkurorzimi në kundërshtim me to.2.Numri i ndarjeve.3.Shkurorzimi në raste të mospajtimeve mes bashkëshortëve.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 325-372

Java e trembëdhjetë: 1. Periudha e pritjes.2.Rastet e pritjes.3.Llojet e pritjes.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 391-400

Java e katërbëdhjetë:

1. Kujdestaria për fëmijët. 2. Kujdestaria është e drejtë e përbashkët. 3. Nëna ka më shumë të drejtë për kujdestarinë e fëmijës se babai. 4. Renditja e personave që kanë të drejtë për kujdestarinë e fëmijës.

Literatura: Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s. faqe 407-410

Java e pasëmbdhjetë: 1. E drejta e fëmiut në gjidhënie. 2. Gjidhënia a është obligim i nënës. 3. kushtet e gjidhënies në bazë të të cilave ndalohet martesë. 4. Si vërtetohet gjidhënia

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final: **40 pikë**

Literatura obligative:

1. Fikhu Sunneh Sejid Sabik, Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s.

Literatura konsultative:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti.
2. Fahrudin Ebibi (grup autorësh), *E Drejta Familjare në Islam*, Shkup, 2004
3. Tituj të zgjedhur mbi Familjen Muslimane, (grup autorësh) Prishtinë, 2001

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të përcjellin ligjëratat dhe të marrin pjesë në to. Ata stimulohen për pjesëmarrje aktive në mënyrë që të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë dhe kualitetit të mësimdhënies.

Me këshilla dhe biseda të vazhdueshme porositen që të respektojnë rregullat e mirësjelljes dhe të kultivojnë virtyte morale të cilat aq shumë i promovon Islami.